

August 10, 1964

**Meeting between the North Vietnamese ambassador
with the 1st vice-minister of foreign affairs of the
People's Republic of Albania Vasil Nathanaili**

Citation:

"Meeting between the North Vietnamese ambassador with the 1st vice-minister of foreign affairs of the People's Republic of Albania Vasil Nathanaili", August 10, 1964, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1964, D 251/1, p. 66-72
<https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/113555>

Summary:

This document outlines the meeting between the North Vietnamese ambassador with the 1st vice-minister of foreign affairs of the People's Republic of Albania, Vasil Nathanaili. The ambassador thanks the Albanian government for the August 7 declaration in support of North Vietnamese sovereignty and independence. He informs the Albanian official about the growing pressure of the American government on the United Nations to become more involved in the conflict in Vietnam and to spread the blame for violating the Geneva Convention of 1954 on Indochina to North Vietnam. It is stated that the Soviet representative in the UN proposed to invite a North Vietnamese delegation to discuss the situation in Vietnam without previously informing the North Vietnamese government about the issue, prompting an official complaint to the Soviet embassy in Hanoi. Furthermore, the American representatives in the UN invited a South Vietnamese delegation in order to discuss the same issue. The document also mentions the reaction of the North Vietnamese government after the supposed violation of the Geneva Convention and specific steps to condemn the Americans publicly.

Original Language:

Albanian

Contents:

Original Scan

V. f
Dosja
Flet
RK34
1 DEKLASIFIKUAR

Vietnam 1964

8. III/4

A/5-3

MPJ ARKIVI
Viti;
Dosja
Fleta:

Relacion takimi i ambasadorit te Republikes
Demokratike te Vietnamit, shokut Nguen Ngoc-Son
me Zevendes Ministrin e Pare te Ministrise Puneve
Jashtme shokun Vasil Nathanaili

Me kerkesen e ambasadorit te Republikes Demokratike te Vietnamit, shokut Nguen Ngoc-Son me 10 gusht 1964 ora 8.30 u be takimi me Zevendes Ministrin e pare te P. Jashtme shokun Vasil Nathanaili.

I.- Ne fillim te bisedes ambasadori i Republikes Demokratike te Vietnamit falenderoi per zemersisht ne emer te Qeverise se Republikes Demokratike te Vietnamit per deklaraten e Qeverise te Republikes Popullore te Shqiperise mbi veprimet agresive te armatosura te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes kunder Republikes Demokratike te Vietnamit, si dhe per deklaratat e organizatave te masave ne perkrahje te Republikes Demokratike te Vietnamit. Shoku Nguen Ngoc-Son njoftoi se persa me siper eshte njoftuar Qeveria e Republikes Demokratike te Vietnamit.

Shoku ambasador foli mbi qellimet e akteve agresive te imperializmit amerikan ne Vietnam si dhe mbi diskutimin e ketij problemi ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara.

Shoku Nguen Ngoc-Son i cilesoi veprimet e imperializmit amerikan si akte agresive te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes. Keto akte, theksoi ai, jane pjese perberese e planeve te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes per ekspansion, te pregatitura dhe te planifikuara prej kohesh.

Qarqet imperialiste te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes, vuri ne dukje shoku ambasador, nga njera ane po dergojne trupa ne Azine Jug-Lindore dhe nga ana tjeter po aktivizojne politiken imperialiste ne arenen nderkombetare.

MPJ ARKIVI
Viti
Dosja
Fleta
DEKLASIFIKUAR

- 2 -

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja No:
Fleta:

Sipas ambasadorit te Republikes Demokratike te Vietnamit Shtetet e Bashkuara e bejne kete se pari, per ti kaluar veshtiresite dhe disfatat e nje pas nje_shme ne Laos. Se dyti, keto akte agresive kane lidhje te ngushte me vete gjendjen e bren-deshme politike te krijuar ne Shtetet e Bashkuara t'Amerikes ne vigjiljen e zgjedhjeve te reja presidenciale.

Ne momentin e tanishem SHBA po nxisin Organizaten e Kombeve te Bashkuara per nderhyrje ne Vietnam. Nga njoftimet e fundit, tha shoku Ambasador perfaqesuesi i BRSS ka kerkuar ftuarjen e te deleguarit te qeverise se Republikes Demokratike te Vietnamit ne diskutimin e ketij problemi. Njekohesisht, SHBA, nga ana e tyre, gjithashtu insistojne ne ftuarjen e nje delegacioni nga klika qeveritare e Sajgonit.

Taktika e ndjekur nga Shtetet e Bashkuara t'Amerikes, theksoj shoku Ambasador, synon :

1) Te godasi politikisht qendrimin konsequent dhe paqesdashes te Republikes Demokratike te Vietnamit.

2) Shtetet e Bashkuara t'Amerikes duan ta perdorin Organizaten e Kombeve te Bashkuara si mjet per nje nderhyrje "legjitime" ne Vietnam.

3) Duke u perpjekur te legalizoje nje intervencion kunder Republikes Demokratike te Vietnamit nen flamurin e Organizates se Kombeve te Bashkuara, Qeveria e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes desheron te injoroje dhe te heqi dore nga pergjegjësia e saj per shkeljen e marreveshjeve te Gjeneves te vitit 1954 per Indokinen.

Persa me siper, shoku Nguen Ngoc-Son, njofton se Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes Demokratike te Vietnamit do te beje nje deklarate, duke prekur keto çeshtje :

a) Shtetet e Bashkuara t'Amerikes te konsiderohen si agresore

b) Shtetet e Bashkuara t'Amerikes kane shkelur ne menyren me flagrante marreveshjet e Gjeneves te vitit 1954

MPJ RKJ
V. t
Dosja Flet
I DEKLASIFIKUAR

- 3 -

MPJ ARKIVI
Viti;
Dosja
Fleta:

c) Te kerkohet respektimi rigoroz i marreveshjeve te Gjeneves te vitit 1954 , te cilat permbajne nje seri dispozitash me shume rendesi.

1) Te gjithë shtetet pjesemarres dhe neneshkruese te marreveshjeve te Gjeneves te vitit 1954 duhet te respektojne dispozitat per Vietnamin, Laosin dhe Kamboxhien.

2) Te respektojne sovranitetin e Vietnamit, Laosit dhe Kamboxhit.

3) Te respektohet mos nderhyrja ne punet e brendeshme te tyre.

4) Temos lejohet dergimi i trupave, kontigjenteve te reja ushtarake dhe armatimeve si p.sh. aeroplane luftarake, anije luftarake, topa, tanke, autoblinda etj. ne Indokine.

5) Tendalohet instalimi i bazave ushtarake te huaja ne keto vende.

6) Te mos lejohet ne te dy zonat, qe Republika Demokratike e Vietnamit dhe Vietnami i Jugut te kthehen ne baza ushtarake.

7) Te mos lejohet futja e te dy zonave (d.m.th. Republika Demokratike e Vietnamit dhe Vietnami i Jugut) ne koalicio-ne ose blloqe ushtarake te huaja.

8) Te mos lejohen ndermarja e akteve luftarake nga te dy zonat te drejtuara kundra njera tjetres.

9) Te mos lejohet zbatimi i politikës së nderhyrjes ne punet e brendeshme nga shtetet e huaja ne te dy pjeset e Vietnamit.

Me tej ambasadori i Republikës Demokratike te Vietnamit theksoi se qeveria e tij zbaton ne menyre me te perpike marreveshjet e Gjeneves te vitit 1954 per Indokinen dhe se ajo ,

./.

nga ana e saj,kerkon nga pjesemarresit e tjere qe edhe ata te zbatojne dhe ti respektojne ato.

Ai vuri ne dukje gjithashtu se aktet agresive te ndermarra nga Shtetet e Bashkuara t'Amerikes dhe sherbetoret e tyre tregojne se imperializmi amerikan i ka shkelur dhe po i shkel ne menyre me te pa skrupullte keto marreveshje.

Qeveria e Republikes Demokratike te Vietnamit,theksoi shoku Ambasador,duke kerkuar zbatimin rigoroz te marreveshjeve te Gjeneves, e quan te domosdoshme te deklaroi se si komisioni nderkombetar per mbikqyrjen e zbatimit te marreveshjeve te Gjeneves te vitit 1954, ashtu dhe te dy bashkekryetaret mbajne pergjegjesi per detyrimet dhe angazhimet qe rrjedhin prej tyre.

Qeveria e Republikes Demokratike te Vietnamit kerkon:

1) te dy bashkekryetaret dhe pjesemarresit e tjere te marreveshjeve te Gjeneves te vitit 1954 per Indokinen te denojne agresionin e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes.

2) te kerkohet me vendosmeri qe qeveria e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes te zbatoje plotesisht detyrimet qe rrjedhin nga keto marreveshje.

3) ti jepet fund agresionit te Shteteve te Bashkuara ne Republikën e Vietnamit te Jugut dhe kunder Republikes Demokratike te Vietnamit.

4) te largohen perfundimisht te gjitha forcat ushtarake te Shteteve te Bashkuara t'Amerikes nga Vietnami i Jugut.

Ambasadori i Republikes Demokratike te Vietnamit theksoi edhe nje here se qeveria e tij proteston energjikisht per paraqitjen e ketij problemi Organizates se Kombeve te Bashkuara , si nje akt te pa drejte dhe kundersizim me marreveshjet e Gjeneves per Indokinen.

Lidhur me qendrimin sovjetik ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara shoku Ambasador njoftoi se inisiativa e perfaqesuesit

MPJ ARKIVI
Viti;
Dosja
Fleta:
I DEKLASIFIKUAR

- 5 -

sovjetik ne Organizaten e Kombeve te Bashkuara per ftimin e nje perfaqesuesi te Republikes Demokratike te Vietnamit lidhur me problemin e lartpermendur eshte e qeverise se BRSS, duke mos patur aprovimin nga ana e qeverise se Republikes Demokratike te Vietnamit.

Per nje qendrim te tille, shoku Nguen Ngoc-Son, ne menyre teper konfidenciale e sekrete i njoftoi shokut Vasil Nathanaili se nga ana e qeverise se Republikes Demokratike te Vietnamit eshte bere proteste prane ambasadave te BRSS dhe te Republikes Socialiste Çekosllovake ne Hanoi.

II.- Mbi marreveshjet e Gjeneves

Shoku Ambasador e quajti te domosdoshme qe te fliste posaçerisht mbi marreveshjet e Gjeneves te vitit 1954. Qe ne fillim te shtruarjes se ketij problemi ai beri pyetjen: "A do te mblidhet konferenca e Gjeneves apo jo?". Sipas mendimit te shokut ambasador, ne se do te theritesh konferenca e Gjeneves, ne te do te flitesh mbi masa per ti zbatuar marreveshjet per Indokinen. Shoku Nguen Ngoc-Son shprehu opinionin e tij se marreveshjet e Gjeneves per vitin 1954 kane nje baze te shenddshe dhe se vetem Shtetet e Bashkuara t'Amerikes dhe pasonjesit e tyre nuk duan ti respektojne ato.

Qeverija e Republikes Demokratike te Vietnamit nuk e ka permendur thirrjen perseri te konferences se Gjeneves, sepse:

Shtetet e Bashkuara i kane shkelur keto marreveshje dhe se raporti i forcave nuk ka favorizuar dhe nuk favorizon tani thirrjen e nje konference te tille.

Me tej shoku ambasador tha se shpesh qellon qe te konfondohen Konferenca e Gjeneves per Indokinen e vitit 1954 dhe thirja e nje konference per Laosin qe duhet te behet me pjesemarrjen e 14 shteteve. Dihet se inisiativa per thirrjen e nje konference te te 14-tve per Laosin eshte bere me inisiativen tone, theksa

MPJ ARKIVI
Viti: Dosja: Fleta:
71
MPJ ARKIVI
Viti: Dosja: Fleta:
DEKLASIFIKUAR

- 6 -

shoku ambasador, duke permendur dhe Republikën Popullore të Kines. Imperialistët amerikanë kërkojnë thirrjen e një konference mbi Laosin vetëm me pjesëmarrjen e të gjashtëve: të Polonisë, Indisë, Kanadës, BRSS dhe Laosit. Në këtë mënyrë ndërmiret dhe planifikohet izolimi i Patet-Laosit.

Shoku Nguen Ngoc-Son tha : " Prandaj në këto momente kërkuar dhe propozuar një konference për Laosin me pjesëmarrjen e 14-tëve"

Sipas mendimit të shokut ambasador në rast se do të konvokohet një konference mbi Laosin dhe në të do të diskutohet çështja e Vietnamit, Republika Demokratike e Vietnamit do të marrë pjesë në një diskutim të tillë.

Shoku Vasil Nathanaili pyeti shokun ambasador se cili do të ishte qëndrimi i Qeverisë së tij nëse nga të dy bashkëkryetarët ose nga komisioni ndërkombëtar për mbikqyrjen e zbatimit të marrëveshjeve të Gjenevës të vitit 1954 do të ndërmirësh inisiativa për thirrjen e një konference për Indokinen, pavarësisht nga rrethanat dhe raporti i forcave që konsiderohet jo i pershtatshëm në momentin aktual.

Shoku ambasador në përgjigje tha se pjesëmarrja e Republikës Demokratike të Vietnamit do të vendosesh pasi qeveria e tij do ta shikonte se si do të shtrohesh problemi.

Shoku Vasil Nathanaili falenderoi shokun Ambasador për informacionin e dhënë. Me tej shokut Nguen Ngoc-Son iu tha se në deklaratën e qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë theksohet dhe vihet në dukje se Republika Demokratike e Vietnamit ka zbatuar me rigorozitet marrëveshjet e Gjenevës për Indokinen për vitin 1954. Shoku Vasil Nathanaili shtoi se çështja e thirrjes së një konference për Indokinen nuk u përmend në deklaratën e qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë sepse nga studimi dhe vëmdnja e duhur që ju kushtua materialeve rezultonte se qeveria e Republikës Demokratike të Vietnamit në momentin aktual nuk shpreheshë për një inisiativë të tillë.

MPJ ARKIVI
V
105,6
e
MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja: Fleta:
- 7 -

Shoku Vasil Nathanaili e quajti si nje detyre internacio-
naliste qendrimin dhe perkrahjen qe populli dhe qeveria e Republi-
kes Popullore te Shqiperise i jep popullit vella vietnamez dhe
qeverise se Republikes Demokratike te Vietnamit.

Shoku ambasador duke falenderuar edhe nje here ju lut
shokut Vasil Nathanaili qe te ngrihet zeri kunder agresionit te
imperializmit amerikan ne OKB nga perfaqesuesi i Republikes Popu-
llore te Shqiperise duke denoncuar aktet luftenxitesse te qeverise
se Shteteve te Bashkuara t'Amerikes. Shoku ambasador edhe nje here
ritheksoi se ne se Organizata e Kombeve te Bashkuara do te
nderhyje ne Vietnam kjo do te legalizonte krejtesisht intervencio-
nin e Shteteve te Bashkuara t'Amerikes.

Duke folur per aktet pirateske te aviacionit ushtarak
te SHBA ai theksoi se forcat ajrore amerikane kane bombarduar
rajonin e Honga-it qender e minierave te qymyr-gurit, por deme
duk ka pasur. Me 9/VIII/1964 nga sulmet ajrore te pirateve amerikan
te ajrit u dogj nje depo benzine. Ka humbje ne njerez. Jane vrare
20 ushtare dhe 1 qytetar vietnameze.

Biseda ishte e hapet , e perzemerte dhe zgjati rreth
1 ore e 30 minuta.

Tirane, me 10/VIII/1964

Vasil Nathanaili

